



# Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

## AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	21.11.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-4047/18
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ, Menaxher i Sektorit për Prokurim në Komunën e Prizrenit
CC:	z. Mytahir HASKUKA Kryetar i Komunës së Prizrenit
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: "Krijimi dhe mirëmbajtja vjetore e web faqes së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik"

*I nderuari z. Osmankaj,*

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "**Krijimi dhe mirëmbajtja vjetore e web faqes së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik**" ", me numër të prokurimit: 622/18/8865/221, dhe me nr. të brendshëm: 622/18/105/221. Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

### OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "**Krijimi dhe mirëmbajtja vjetore e web faqes së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik**" ", me numër të prokurimit: 622/18/8865/221, dhe me nr. të brendshëm: 622/18/105/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat

përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L - 237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

### *A r s y e t i m i*

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 20 nëntor 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoll: *AKK-03-03-4047/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "**Krijimi dhe mirëmbajtja vjetore e web faqes së Drejtorisë së Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik**", me numër të prokurimit: 622/18/8865/221, dhe me nr. të brendshëm: 622/18/105/221, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Komuna e Prizrenit.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, të llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar prej 24, 000.00 €.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma *E-Prokurimi* ka vërejtur se në njoftimin për kontratë tek pjesa e kriterëve për dhënie të kontratës autoriteti kontraktues si kriter për dhënie të kontratës ka caktuar kriterin *Tenderi ekonomikisht më i favorshëm*, ndërsa si nën kriterë ka caktuar: **1.** Çmimin të cilit i ka caktuar koeficientin prej 0.50 %, **2.** Prezantimi i portfolios së OE në formë të katalogut ose listës për tri vitet e shkuara e përcjellë me kontratat dhe referenca të natyrës së kontratës, si dhe ndonjë dëshmi mbi kualitetin e shërbimeve të kryera të cilit i ka caktuar koeficientin 0.10%, **3.** Plani dinamik i dizajnit të përmbajtjes si dhe i plasimit të web faqes të cilit i ka caktuar koeficientin 0.10%, **4.** Prezantimi i web faqes së Drejtorisë së turizmit e shtypur në formatin A3 si dhe e regjistruar në CD të cilit i ka caktuar koeficientin, dhe **5.** Afati dhe kushtet e mirëmbajtjes së web faqes pas funksionalizimit të saj ( afati nuk guxon të jetë më i shkurtër se 24 kalendarik) .

Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit **2.** *Prezantimi i portfolios së OE në formë të katalogut ose listës për tri vitet e shkuara e përcjellë me kontratat dhe referenca të natyrës së kontratës, si dhe ndonjë dëshmi mbi kualitetin e shërbimeve të kryera,* nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, për faktin se në nenin 28 paragrafi 3 Rregullat dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimi Publik, specifikohen qartë cilat kriterë mund të caktohet te kriteri i dhënies Tenderi ekonomikisht ma i favorshëm.

Agjencia, konsideron se autoriteti kontraktues duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve për dhënie të kontratës. Sipas Legjislacionit në fuqi kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kriterë për dhënie të kontratës, andaj konsiderojmë se nën kriteri si më lartë i vendosura në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit mund të caktohen si kriter minimale për kualifikim, por i njëjti nuk mund të përdoret edhe për dhënie të kontratës.

Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ të Prokurimit Publik (RRUOP) në nenin 26.5 parashihet se “ Kriteret e përzgjedhjes në asnjë mënyrë nuk mund të përdoren si kritere të dhënies së kontratës, nuk mund të kenë peshë të caktuara, ato janë kërkesa të vlerësimit kalon/nuk kalon “.

Po ashtu Agjencia kundër Korrupsionit, konsideron se autoriteti kontraktues me rastin e caktimit të nën kriterit për dhënie të kontratës te nën kriterin nr. 3. “*Plani dinamik i dizajnit të përmbajtjes si dhe i plasimit të web faqes*”.., nuk ka respektuar Legjislacionin në fuqi të Prokurimit Publik, për faktin se autoriteti kontraktues planin dinamik të dizajnit mund ta parashihen ne Kushtet e veçanta të kontratës siç parashihet në nenin 6.1 , ku thuhet: *Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve*.

Nenin 28 paragrafi 3 të RRUOP parashihet se “ Nëse kriter për dhënie të kontratës është tenderi ekonomikisht më i favorshëm, kontrata duhet t’i jepet tenderit i cili më së miri përmbushë kriteret relevante. Përveç, çmimit Autoriteti kontraktues mund të përfshijë kritere tjera relevante për lëndën e kontratës. *Për shembull, mund të përfshihet: karakteristikat e cilësisë, kostot operative, të mirëmbajtjes dhe kosto tjera të jetë-gjatësisë, karakteristika funksionale, teknike, mjedisore, estetike ose të ngjashme, shërbimi i pas-shitjes dhe asistencës teknike “.*

Autoriteti kontraktues duhet të këtë kujdes që në rast se përcaktohet për këtë kriter për dhënie të kontratës të caktoj nën kritere të qarta, precize, të matshme dhe të cilat kritere janë në pajtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e prokurimit publik në Republikën e Kosovës.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënie të kontratës të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 28 Kriteret për dhënie të kontratës të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shpeshë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

**Me respekt !**